FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.87 25 qershor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7008 datë 6.6.2011	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare……	3611
Vendim i KM nr.389, datë 18.5.2011	Për një shtesë në vendimin nr.1087, datë 23.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Mollas të qarkut të Korçës" dhe për një shtesë në vendimin nr.604, datë 14.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Mollas të qarkut Korçë"……	3612
Vendim i KM nr.397, datë 1.6.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Bajram Curri të qarkut të Kukësit……	3613
Vendim i KM nr.398, datë 1.6.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Portëz, të qarkut të Fierit……	3614
Vendim i KM nr.399, datë 1.6.2011	Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja……	3615
Vendim i KM nr.400, datë 1.6.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë Plloçë (loti I)……	3616
Vendim i KM nr.402, datë 1.6.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z.Ylli Asllani……	3620

Vendim i KM nr.410, datë 8.6.2011	Për transferimin e pronësisë së godinës së ish-Ndërmarrjes së Prodhimit Artizanal (NPA), Shkozet, Durrës, familjeve të shpronësuara në zonën e Porto-Romanos……	3620
Vendim i KM nr.411, datë 1.6.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.776, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e çmimeve të reduktuara të biletave të muzeve publike për kategori të caktuara shoqërore"……	3621
Vendim i KM nr.414, datë 8.6.2011	Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve……	3621
Vendim i KM nr.415, datë 8.6.2011	Për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme……	3624
Vendim i KM nr.416, datë 8.6.2011	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Karbunarë të qarkut të Fierit……	3626
Vendim i KM nr.417, datë 8.6.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Çërravë të qarkut të Korçës……	3627
Vendim i KM nr.418, datë 8.6.2011	Për procedurën e heqjes së licencës së ndërmjetësit……	3628
Vendim i KM nr.419, datë 14.4.2011	Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist……	3629
Vendim i KM nr.420, datë 8.6.2011	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit nr.14869/AVHJEM, për çështjen "Rohde Nielsen vs Ministria e Punëve Publike dhe Transportit"……	3630
Kërkesë e MPPT nr.454/3, datë 8.6.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Librazhd-Qafë Studë"……	3631
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Vitore Ruka……	3634
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Aurel Starova……	3634

DEKRET
Nr.7008, datë 6.6.2011

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Ajvi Bujar Asel (Luzi)
2. Aldi Jashar Seel (Jashari)
3. Artan Ferid Binjaku
4. Blendrit Bërhan Hoxha
5. Denis Osman Bregasi
6. Dhurata Rakip Saraçi (Doci)
7. Dilaver Sulejman Uliu
8. Elken Rasim Buziu
9. Ervehe Vesel Kajo (Saliasi)
10. Florid Flamur Ramadani
11. Flutura Divin Steudle (Abazi)
12. Ilda Veli Clos (Hasimi)
13. Irena Haki Brecht (Baruti)
14. Ismail Riza Saraçi
15. Linda Emin Mezini
16. Luada Adrian Rustemi
17. Lulzim Myzafer Staben (Kraja)
18. Marsida Osman Bregasi
19. Mimoza Nafi Bregasi (Gjona)
20. Mimoza Selman Schmidt (Mustafaj)
21. Osman Laver Bregasi
22. Petrit Meleq Kajo
23. Qirjako Kostandin Penelli
24. Renè Ismail Saraçi
25. Shpresa Riza Fazlioska (Puka)
26. Sonila Ali Ago (Koutsopoulos)
27. Sulltana Nexhbedin Qoli (Tola)
28. Tedi Arben Limani
29. Valbona Sadik Kadillari (Duka)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.389, datë 18.5.2011

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.1087, DATË 23.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN MOLLAS TË QARKUT TË KORÇËS", DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.604, DATË 14.5.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS MOLLAS TË QARKUT KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Mollas të qarkut të Korçës, të miratuar me vendimin nr.1087, datë 23.7.2008 të Këshillit të Ministrave.

Lista është me 2 (dy) fletë dhe përfundon me numër rendor 63 (gjashtëdhjetë e tre).

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial e administrativ dhe në pronësi të komunës Mollas të qarkut të Korçës, të miratuar me vendimin nr.604, datë 14.5.2008 të Këshillit të Ministrave.

Lista është me 1 (një) fletë dhe përfundon me numër rendor 13 (trembëdhjetë).

3. Lista shtesë e inventarit, lista shtesë e pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të komunës dhe tabela me lidhjen numër 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Mollas e qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore Mollas, qarku Korçë — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
408-412, 417, 419-420, 422	Pyje dhe kullota	Në pronësi
424, 438-440		

VENDIM
Nr.397, datë 1.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BAJRAM CURRI TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Bajram Curri, të qarkut të Kukësit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Bajram Curri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Bajram Curri — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1, 158, 159	Prona që përdoren në ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
14-19, 160	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore (prona nr.21 është në katin përdhe të një pallati 5-katësh)	Në pronësi
38-51, 53, 54, 161, 172	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile dhe strehimit	Në pronësi
56, 57, 162	Prona që përdoren në fushën e shërbimeve sociale	Në pronësi
58-67, 163-166, 173	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
68, 69	Varrezat publike	Në pronësi
81, 82	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
22, 23, 84-91, 92 95, 100, 167-170	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike) rrugë vendore	Në pronësi
99	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
104, 171	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
125-128	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
129, 130	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr.398, datë 1.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PORTËZ, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Portëz të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Portëz, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.168, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Portëz, të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Portëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Portëz — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-15, 17-48, 52, 55, 56-63, 65, 66, 68-72	Prona që përdoren në ushtrimin e funksioneve në fushën pyje-kullota	Në pronësi
73	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
74-84	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
85-92	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
93, 94, 99, 100, 102, 109-131, 139-146	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
154-165	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
166-180	Varrezat publike	Në pronësi
181-210	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
214-227	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
95-98, 101, 103-108, 132, 133-138, 147-151, 353, 439-441, 444-448, 451, 452, 453/1, 453/2	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
438, 442, 443, 449, 450, 453, 454	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
455-458	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.399, datë 1.6.2011

PËR PËRBËRJEN DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË MIRATIMIT TË AGJENCIVE NDËRMJETËSUESE TË HUAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 081 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe të pikës 2 të nenit 33 të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ngritjen e Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, me qëllim njohjen dhe miratimin e agjencive ndërmjetësuese të huaja për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit (më poshtë Komisioni).

2. Komisioni funksionon si organ kolegjial, vendimmarrës, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

II. PËRBËRJA E KOMISIONIT

1. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve tre janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë (zëvendësministër, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit, përgjegjës i strukturës që mbulon çështjet për të mitur), dhe dy janë përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

2. Komisioni, përmes votimit nga anëtarët e tij, zgjedh kryetarin dhe sekretarin.

III. RREGULLAT PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT

1. Komisioni mblidhet, me kërkesë të kryetarit, sa herë informohet nga sekretari, për paraqitjen pranë Ministrisë së Drejtësisë të, maksimumi, 5 (pesë) kërkesave të reja nga agjencitë ndërmjetësuese të huaja, për njohje dhe miratim, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së tyre në fushën e birësimit. Data e mbledhjes u njoftohet anëtarëve të komisionit të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj.

2. Agjencitë ndërmjetësuese të huaja paraqesin kërkesën e tyre, për njohje dhe miratim, pranë komisionit.

3. Kërkesa plotësohet sipas formularit tip, i cili miratohet nga komisioni me propozimin e kryetarit. Ajo shoqërohet me dokumentet e nevojshme, të cilat vërtetojnë përmbushjen e kritereve të parashikuara në ligj dhe depozitohet pranë komisionit.

4. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten nga agjencitë ndërmjetësuese të huaja, të interesuara, janë këto:

a) formulari tip, i plotësuar;

b) jetëshkrimi i drejtuesit dhe i stafit të agjencisë ndërmjetësuese të huaj;

c) dokumenti që vërteton identitetin e personit të autorizuar për të paraqitur kërkesën (pasaportë apo letërnjoftim);

ç) kopje e noterizuar e vendimit të regjistrimit në gjykatë si person juridik në Shqipëri;

d) formulari i plotësuar i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;

dh) kopje e autorizimit, nga shteti përkatës, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e birësimit;

e) kopje e noterizuar e statutit dhe aktit të themelimit të agjencisë ndërmjetësuese të huaj;

ë) vërtetimi, nga organet tatimore, për shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) përshkrimi i veprimtarisë së agjencisë ndërmjetësuese të huaj;

g) dokumenti që provon pagesën e tarifës së licencimit;

gj) dokumente të tjera që vlerësohen të nevojshme nga komisioni.

5. Komisioni merr në shqyrtim kërkesat e depozituara dhe, pasi verifikon përmbushjen e kritereve të parashikuara në ligj, merr vendim brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës.

6. Mbledhja e komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

7. Komisioni refuzon kërkesën në rast se:

a) kërkuesi nuk është i autorizuar për të paraqitur kërkesën;

b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përmbajtja e tij nuk duket qartë apo është e palexueshme;

c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme;

ç) kërkuesi nuk përmbush kriteret e parashikuara në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve", të ndryshuar;

d) nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit.

8. Komisioni mund t'ia heqë licencën agjencisë ndërmjetësuese të huaj, që ushtron veprimtarinë në fushën e birësimit, në këto raste:

a) me kërkesë të agjencisë ndërmjetësuese të huaj;

b) kur vërtetohet se shteti përkatës ia ka hequr autorizimin si agjenci ndërmjetësuese e huaj në fushën e birësimit;

c) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale, të kryer me dashje;

ç) kur vërtetohet shkelja e dispozitave të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve", të ndryshuar;

d) në çdo rast tjetër, kur parashikohet shprehimisht në ligj.

9. Kundër vendimit të komisionit, agjencia ndërmjetësuese e huaj ka të drejtë të paraqesë, brenda 10 ditëve, ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, i cili shprehet me vendim brenda 10 ditëve nga data e marrjes së ankimit.

10. Vendimi i komisionit i përcillet strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për ta regjistruar në regjistrin e krijuar për këtë qëllim pranë kësaj ministrie dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Komisioni, në mbledhjen e parë, zgjedh kryetarin dhe sekretarin e tij.

2. Komisioni, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, merr në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacionin shoqërues, për njohje dhe miratim, të paraqitura nga agjencitë ndërmjetësuese të huaja, për të cilat Komiteti Shqiptar i Birësimeve nuk ka vendosur ende.

3. Pranë Ministrisë së Drejtësisë, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, krijohet regjistri, me urdhër të ministrit, sipas pikës 11 kreu III të këtij vendimi, ku depozitohen gjitha të dhënat e agjencive ndërmjetësuese të huaja, të licencuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përcjella nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

4. Ministri i Drejtësisë, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, cakton personin e autorizuar përgjegjës për të pasur akses në sistem dhe për të publikuar të dhënat e nevojshme për licencat sipas këtij vendimi, në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Komiteti Shqiptar i Birësimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.400, datë 1.6.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QUKËS-QAFË PLLOÇË (LOTI I)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës-Qafë Plloçë (loti I).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen tokë arë prej 16 652 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) m^2 me vlerë 3 367 379 (tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë; sipërfaqen tokë truall 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë) m^2, me vlerë 182 105 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e pesë) lekë; kultura bujqësore dhe drufrutorë me vlerë 755 430 (shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 4 304 914 (katër milionë e treqind e katër mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 550 000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 4 304 914 (katër milionë e treqind e katër mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 15.6.2011 dhe të përfundojë më 15.11.2011.

7. Për pasurinë në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilën në kolonën përkatëse është bërë shënimi "Proces gjyqësor", të kompensohet, për efekt shpronësimi, personi apo personat që do të rezultojnë pronarë, pasi të jetë marrë vendim i formës së prerë nga gjykata dhe pas regjistrimit, në bazë të këtij vendimi, pranë ZVRPP-së, Librazhd.

8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmohet nga ZVRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Pronarët e pasurive për të cilët është bërë shënimi në kolonën përkatëse "Konfirmuar nga ZRPP-ja/konflikt pronësie", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të zgjidhet konflikti, fakt për të cilin do të jepet konfirmim zyrtar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilët janë bërë shënimet përkatëse "Konfirmohet nga ZVRPP-ja", "Proces gjyqësor" dhe "Konfirmuar nga ZVRPP-ja/konflikt pronësie", në bazë të pikave 7, 8 dhe 9 të këtij vendimi.

11. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

12. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR "QUKËS-QAFË PLLOÇË", LOTI I

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K.	Numri i pasurisë	Tokë arë			Tokë truall			Kult. bujq drufrutore (lekë)	SHUMA TOTALE (lekë)	Shënime
						Sip. m^2	Çmimi (lekë/m^2)	Shuma (lekë)	Sip. m^2	Çmimi (lekë/m^2)	Shuma (lekë)			
	Fshati Qukës-Shkumbin Komuna Qukës Z.K. 3120													
1	"Albania Tabak"			3120	443/17				115	847	97405		97405	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Agim	Sali	Leka	3120	443/40	477	149	71073				65100	136173	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Arben	Ali	Leka	3120	443/41	298	149	44402					44402	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Nexhmije	Estref	Leka	3120	443/42	425	149	63325				24500	87825	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Fshati Berzeshtë Komuna Qukës Z.K. 1169													
5	I papërcaktuar			1169	1088/5	1920	184	353280					353280	Proces gjyqësor
6	Vladimir	Gani	Bardho	1169	1088/3	480	184	88320					88320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Avni	Sabri	Koçoli	1169	1088/4	950	184	174800					174800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Gani		Zogolli	1169	1059/1	390	184	71760					71760	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Ilirjan Dashamir Behare		Leka Leka Leka	1169	1059/2	200	184	36800					36800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Ilirjan Dashamir Behare		Leka Leka Leka	1169	1058/4	284	184	52256				17860	70116	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Petref		Leka	1169	1058/2	31	184	5704				5020	10724	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Burbuqe		Çerma	1169	1067/2	45	184	8280				10040	18320	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Shahe		Dashballa	1169	1069/3	365	184	67160				23040	90200	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Pellumb		Leka	1169	1064/1	80	184	14720					14720	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Liman	Muharrem	Dashballa	1169	1069/2	240	184	44160				15450	59610	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Fshati Karkavec Komuna Qukës Z.K. 2096													
16	Haki	Maksut	Gega	2096	232/1	1145	217	248465				52440	300905	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Mersin		Gega	2096	232/3	240	217	52080				4660	56740	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Ibrahim		Alla	2096	232/4	20	217	4340				1020	5360	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	Dritan		Radiçi	2096	239/2	500	217	108500				9000	117500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Demir	Merko	Blloshmi	2096	363/5	1450	217	314650				60270	374920	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	Demir	Merko	Blloshmi	2096	363/4	195	217	42315					42315	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
22	Hekuran	Ramadan	Radiçi	2096	364/9	169	217	36673				21250	57923	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	Hyrije	Nuredin	Radiçi	2096	364/10	180	217	39060				10600	49660	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
24	Isuf		Radiçi	2096	364/11	210	217	45570				11760	57330	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	Hajdar	Sejfulla	Radiçi	2096	364/12	255	217	55335				20770	76105	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	Hyrije	Demir	Radiçi	2096	364/13	640	217	138880				30920	169800	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	Dilo	Dilaver	Radiçi	2096	364/14	510	217	110670				20900	131570	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	Bajram		Radiçi	2096	364/15	788	217	170996				21400	192396	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

29	Petrit		Zogolli +BP	2096	369/7	110	217	23870				13600	37470	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	Skender		Radici	2096	370/10	80	217	17360				16000	33360	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	Eduart	Xhevat	Gjymenga	2096	370/8	490	217	106330				37550	143880	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	Feride		Radiçi	2096	370/9	625	217	135625				117200	252825	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	Bujar		Radaku	2096	369/2	250	217	54250				6010	60260	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	Shahin		Osmeria	2096	418/6	280	217	60760				35890	96650	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	Hysen		Osmeria	2096	418/4	280	217	60760				13690	74450	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	Mersin		Osmeria	2096	418/1	490	217	106330				25490	131820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	I papërcaktuar			2096	420/9	450	217	97650	100	847	84700		182350	Konfirmuar nga ZVRPP-ja /konflikt pronësie
38	Esma		Qyra +BP	2096	420/12	910	217	197470				51100	248570	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	Esma		Qyra +BP	2096	420/15	200	217	43400				12900	56300	
		TOTALI				**16652**		**3367379**	**215**		**182105**	**755430**	**4304914**	

VENDIM
Nr.402, datë 1.6.2011

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z.YLLI ASLLANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri "Mallra dhe shërbime", t'i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z.Ylli Asllani.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.410, datë 8.6.2011

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË GODINËS SË ISH-NDËRMARRJES SË PRODHIMIT ARTIZANAL (NPA), SHKOZET, DURRËS, FAMILJEVE TË SHPRONËSUARA NË ZONËN E PORTO-ROMANOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe të neneve 3 pika 2, e 7 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, pa kundërshpërblim, të një pjese të mjediseve të ish-Ndërmarrjes së Prodhimit Artizanal (NPA), në administrim të bashkisë Durrës, të përshtatur sipas marrëveshjes për ambjente banimi për familjet e shpërngulura nga zona e Porto-Romanos, pronë e shtetit shqiptar, në pronësi private të banorëve të shpërngulur, sipas listës që i bashkëlidhet aneksit 1 dhe që është pjesë përbërëse e këtij vendimi, në përmbushje të detyrimit të shtetit shqiptar, të caktuar sipas pikës 2, shkronja (b)"i", të shtojcës së marrëveshjes së kredisë për zhvillim nr.4038, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit "Menaxhimi i integruar dhe pastrimi i zonës bregdetare".
2. Ngarkohet bashkia Durrës të depozitojë pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Durrës, dokumentacionin e nevojshëm, teknik dhe ligjor, të kalimit të një pjese të mjediseve të ish-Ndërmarrjes së Prodhimit Artizanal (NPA) sipas pikës 1 të këtij vendimi, për regjistrimin e këtij dokumentacioni dhe pajisjen e qytetarëve të caktuar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me aktin e pronësisë së ambientit të ndërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Familjes së z.Isuf Tufa, me sipërfaqe ndërtimi 55 m^2
Familjes së z.Besnik Kika, me sipërfaqe ndërtimi 81.7 m^2
Familjes së z.Rustem Dalipi, me sipërfaqe ndërtimi 51.52 m^2
Familjes së z.Xhevahir Smeli, me sipërfaqe ndërtimi 50.58 m^2
Familjes së z.Hajredin Jana, me sipërfaqe ndërtimi 50.58 m^2

VENDIM
Nr.411, datë 1.6.2011

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.776, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR VENDOSJEN E ÇMIMEVE TË REDUKTUARA TË BILETAVE TË MUZEVE PUBLIKE PËR KATEGORI TË CAKTUARA SHOQËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 "Për muzetë", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.776, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i fundit i pikës 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Studentët e arsimit të lartë, që kanë kartën e studentit, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nxënësit e sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuar sipas ligjit nr.7952, datë 21.11.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, përfitojnë reduktim në masën 70% të çmimit të biletave.".

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1 Fëmijët deri 8 vjeç përfitojnë hyrje të lirë në muzetë publikë.".

c) Pika 2 shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.414, datë 8.6.2011

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË LICENCIMIT TË NDËRMJETËSVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" dhe të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ngritjen e Komisionit për Licencimin e Ndërmjetësve me qëllim licencimin e subjekteve të interesuara për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësit (më poshtë Komisioni).

2. Komisioni funksionon si organ kolegjial, vendimmarrës, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

3. Rregullat e këtij vendimi zbatohen për ndërmjetësit që ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit në Republikën e Shqipërisë, e cila mund të përfundojë me nënshkrimin e aktmarrëveshjes, të detyruar dhe të ekzekutueshme në Republikën e Shqipërisë.

II. PËRBËRJA E KOMISIONIT

1. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të zgjedhur për një afat trevjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Ministri i Drejtësisë cakton, me urdhër, 3 (tre) përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë në përbërje të komisionit.

3. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit cakton 2 (dy) përfaqësues në përbërje të komisionit. Kryetari i Dhomës njofton, pa vonesë, Ministrin e Drejtësisë për emrat dhe funksionet e përfaqësuesve.

4. Kryetari i komisionit zgjidhet nga anëtarët. Pas mbarimit të mandatit të kryetarit, kryetari i radhës zgjidhet nga përfaqësuesit e institucionit, i ndryshëm nga ai prej ku është zgjedhur kryetari i mëparshëm.

5. Komisioni zgjedh, ndërmjet anëtarëve të tij, zëvendëskryetarin, i cili, kur kryetari mungon ose është në pamundësi për të ushtruar funksionet, ushtron kompetencat e këtij të fundit.

6. Kur kryetari dhe zëvendëskryetari mungojnë apo janë në pamundësi për të ushtruar funksionet e tyre, mbledhja drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

7. Kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit zgjidhen në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë të dy institucionet, Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit. Në asnjë rast të tre funksionarët së bashku nuk mund të zgjidhen nga i njëjti institucion. Pas mbarimit të mandatit të tyre, funksionarët pasues nuk mund të zgjidhen nga i njëjti institucion me ato paraardhës.

III. KUSHTET DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LICENCË

1. Subjekti i interesuar, person fizik apo juridik, paraqet kërkesë për licencim pranë komisionit, kur plotëson këto kushte:

a) të ketë kryer programe të studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për arsimin e lartë;

b) të ketë mbushur moshën 25 vjeç;

c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të veprave penale;

ç) të ketë përfunduar programin e trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit;

d) të ketë një referencë ose rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm ose ai aktual;

dh) të jetë i licencuar dhe i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësve.

2. Kërkesa plotësohet sipas formularit tip, i propozuar nga kryetari dhe i miratuar nga komisioni. Ajo shoqërohet me dokumentet përkatëse, të cilat vërtetojnë përmbushjen e kushteve për ndërmjetës, të parashikuara në ligj, dhe depozitohet pranë komisionit.

3. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten nga personi fizik janë këto:

a) formulari tip, i plotësuar me të gjitha të dhënat e sakta të kërkuara;

b) jetëshkrimi;

c) një dokument që vërteton identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është personi i autorizuar për të paraqitur kërkesën (pasaportë apo letërnjoftim);

ç) një referencë ose rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm ose ai aktual;

d) diploma e noterizuar, për përfundimin e studimeve të ciklit të parë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

dh) formulari i plotësuar i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;

e) vërtetimi i përfundimit të programit të trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit;

ë) një dokument që provon pagesën e tarifës së dhënies së licencës prej 5000 (pesë mijë) lekësh.

4. Dokumentet e nevojshme që duhet të paraqiten nga personi juridik janë, si më poshtë:

a) formulari tip, i plotësuar me të gjitha të dhënat e sakta të kërkuara;

b) jetëshkrimi;

c) një kopje e noterizuar e vendimit të gjykatës për krijimin e personit juridik;

ç) vërtetimi, nga organet tatimore, për shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) vërtetimi i përfundimit të programit të trajnimit dhe të formimit profesional të ndërmjetësve, nga pjesëtarët e personit juridik që do të ushtrojnë veprimtarinë si ndërmjetës, i miratuar nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit;

dh) një dokument që provon pagesën e tarifës së dhënies së licencës;

e) ekstrakti historik dhe ekstrakti i regjistrit tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

IV. RREGULLAT PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT

1. Komisioni mblidhet, me kërkesë të kryetarit ose, të paktën, të tre anëtarëve të tij, sa herë informohet nga sekretari për paraqitjen pranë Ministrisë së Drejtësisë të jo më shumë se 20 (njëzet) kërkesave të reja për licencim. Data e mbledhjes caktohet nga kryetari dhe i njoftohet anëtarëve të komisionit, të paktën, dy ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e saj. Në rast mungese të kryetarit, komisioni mund të mblidhet edhe me kërkesë të zëvendëskryetarit.

2. Rendi i ditës përgatitet nga sekretari dhe i dërgohet çdo anëtari, së bashku me njoftimin për datën e mbledhjes.

3. Mbledhja e komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Kur kjo shumicë nuk është mbledhur caktohet një datë tjetër, brenda tri ditëve pune. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet, pa vonesë, çdo anëtari.

4. Pagesa e anëtarëve të komisionit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, në përputhje me ligjin nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”.

5. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

6. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Votat e anëtarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes.

7. Komisioni merr në shqyrtim kërkesat e regjistruara dhe, pasi verifikon përmbushjen e kushteve të parashikuara në ligj, merr vendim brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimi i komisionit i njoftohet kërkuesit, me shkrim, pa vonesë. Vendimi i refuzimit përmban, në çdo rast, arsyet e refuzimit të kërkesës për licencë.

8. Nëse komisioni, gjatë shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur një dokument të nevojshëm apo dokumenti i paraqitur është i paqartë vendos njoftimin e kërkuesit për sqarimin e tyre brenda një afati gjer në 20 (njëzet) ditë.

9. Komisioni e refuzon kërkesën në rast se, edhe pas kalimit të afatit, sipas pikës 7 të këtij kreu:

a) kërkuesi, nuk është i autorizuar për të paraqitur kërkesën;

b) formulari i plotësuar nuk është i plotë apo përmban korrigjime dhe përmbajtja e tij nuk duket qartë dhe është e palexueshme;

c) nuk janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme, nuk janë paraqitur në formën e kërkuar apo përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tyre nuk duket qartë apo është e palexueshme;

ç) kërkuesi nuk përmbush kushtet për ndërmjetës;

d) nuk është kryer pagesa e tarifës së dhënies së licencës.

10. Kundër vendimit të komisionit, kërkuesit mund të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë mund të bëhet ankim në gjykatë. Paraqitja dhe shqyrtimi i ankimeve bëhet sipas rregullave dhe afateve të parashikuara në ligj për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

11. Pas miratimit të kërkesës për dhënien e licencës, komisioni i paraqet pa vonesë, strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për administrimin e Regjistrit të Ndërmjetësve si dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit, të dhënat e subjekteve të licencuara që kërkohen nga ligji, për regjistrimin e licencës në Regjistrin e Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, i cili mbahet nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

12. Pas licencimit nga komisioni, subjektet regjistrohen në organet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Deri në krijimin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, përfaqësuesit e kësaj Dhome, zgjidhen nga 3 (tre) anëtarët që përfaqësojnë Ministrinë e Drejtësisë, prej listës së kandidatëve të propozuar nga organizatat jofitimprurëse vendase, që veprojnë në fushën e ndërmjetësimit, ose nga organizatat e huaja apo ato ndërkombëtare që mbështesin Ministrinë e Drejtësisë në këtë fushë. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë u dërgon ftesë këtyre organizatave për paraqitjen e propozimeve.

2. Deri në krijimin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, në vend të programit të trajnimit dhe të formimit profesional, i cili duhet të organizohet nga Dhoma, ndërmjetësit duhet të kryejnë, të paktën, një program trajnimi të organizuar nga organizatat jofitimprurëse vendase ose nga organizatat e huaja apo ato ndërkombëtare, që ofrojnë trajnime në fushën e ndërmjetësimit. Kryerja e këtyre programeve të trajnimit duhet të provohet me dokumentin përkatës në çastin e paraqitjes së kërkesës për licencim si ndërmjetës pranë komisionit.

3. Komisioni në mbledhjen e parë të tij zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e tij. Funksionarët e zgjedhur nga përfaqësuesit e organizatave, sipas pikës 1 të këtij kreu, zëvendësohen, pa vonesë, me paraqitjen e përfaqësuesve nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, të cilët vazhdojnë mandatin trevjeçar.

4. Komisioni, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, merr në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacionin shoqërues, për licencimin e ndërmjetësve, të paraqitura nga subjektet e interesuara.

5. Ministri i Drejtësisë, me urdhër, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, krijon Regjistrin e Ndërmjetësve, i cili duhet të sigurojë akses të përdoruesve të sistemit të drejtësisë.

6. Ministri i Drejtësisë, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, cakton personin e autorizuar përgjegjës për të pasur akses në sistem dhe për të publikuar të dhënat e nevojshme për licencat, sipas këtij vendimi, në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë, miratuar për vitin 2011.

8. Ngarkohet Ministri i Financave, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dhe të paraqesë për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin, sipas pikës 4 të kreut IV të këtij vendimi.

9. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.415, datë 8.6.2011

PËR DISA TË DREJTA TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, NË MINISTRINË E BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 51, 52, 53, pika 3, e 55 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të vet, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:

a) Nga 36 km deri 60 km, në masën 3 000 (tre mijë) lekë/muaj;

b) Nga 61 km deri 100 km, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë/muaj;

c) Nga 101 km deri 150 km, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë/muaj;

d) Nga 151 km deri 200 km, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/muaj;

e) Mbi 200 km, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj.

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të SHKB-së, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin që përkon me juridiksionin e njësisë strukturore të SHKB-së, në nivel vendor (në rrethin qendër qarku), ku punonjësi është caktuar.

2. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i SHKB-së paraqet, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, të SHKB-së, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesën me shkrim, me gjenealitetet e plota, në të cilën të përcaktohen:

i. organi ku ka punuar përpara caktimit me punë në strukturën e re;

ii. data e emërimit apo transferimit;

iii. motivi i transferimit (në rast transferimi);

iv. adresa ku banon aktualisht familja e tij;

v. adresa ku banon përkohësisht vetë punonjësi.

b) Fotokopjen e kartës së identitetit, certifikatë e gjendjes civile, personale dhe familjare.

c) Vërtetimin nga komuna/njësia bashkiake/bashkia, ku të vërtetohet se ku banon familja e punonjësit të SHKB-së, si dhe vetë punonjësi, pavarësisht nga gjendja civile.

3. Kur punonjësi i SHKB-së caktohet në punë jashtë vendbanimit të vet dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i humbet marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

a) 50 % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit;

b) 100 % të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 (një) vit deri në 10 (dhjetë) vjet;

c) 100 % të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150 % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 (dhjetë) vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indeksohet me rritjen e pagave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

4. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, punonjësi i SHKB-së paraqet në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse të SHKB-së, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesën me shkrim me gjenealitetet e plota, në të cilën të përcaktohen:

i) organi ku ka punuar përpara caktimit me punë në strukturën e re;

ii) data e emërimit apo transferimit;

iii) motivi i transferimit (në rast transferimi);

iv) adresa ku ka banuar;

v) adresa aktuale ku banon pas caktimit në detyrën e re;

vi) qendra e punës ku ka punuar bashkëshortja/i, data dhe shkaku i largimit nga puna.

b) Librezën e punës së bashkëshortes/it, ku të jetë cilësuar largimi nga puna për arsye të caktimit në detyrën e re të bashkëshortes/it.

c) Vërtetimin nga zyra përkatëse e punësimit, ku të vërtetohet se bashkëshortja/i është regjistruar si punëkërkues i papunë dhe atij/asaj nuk i është ofruar punë në profesionin e saj/tij. Këtë vërtetim punonjësi e paraqet çdo tre muaj.

5. Përveç të drejtës për shpërblim në fund të vitit financiar, parashikuar nga neni 51 pika 5 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, punonjësit të SHKB-së, në kompensim të privacioneve dhe humbjeve, që i krijohen për shkak të kryerjes së detyrave e shërbimeve të veçanta në luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit, i jepet shpërblim deri në 1 (një) pagë mujore në vit.

Ky shpërblim përballohet nga fondi i veçantë dhe mund të jepet përgjatë të gjithë vitit kalendarik. Masa e shpërblimit përcaktohet dhe jepet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së.

6. Personeli me grada i SHKB-së gëzon të drejtën e pushimit vjetor të pagueshëm, në masën, si më poshtë vijon:

a) 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të lartë drejtues, me gradë Drejtor i Përgjithshëm i SHKB-së dhe zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i SHKB-së;

b) 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të mesëm drejtues, me gradë Drejtues i Parë i SHKB-së dhe Drejtues i SHKB-së;

c) 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të parë drejtues, me gradë hetues i parë, dhe punonjësit e nivelit zbatues, me gradë hetues;

ç) 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit zbatues, me gradë agjent i parë, agjent dhe asistent.

7. Punonjësi i SHKB-së, që përfiton sipas pikave 1 e 3 të këtij vendimi, nënkupton punonjësit e përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c" të pikës 1 të nenit 20 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme", duke përfshirë edhe ata të emëruar për së pari në SHKB.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme.

9. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e shfuqizimit të vendimit nr.507, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin për privacionet dhe humbjet, që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit", të ndryshuar.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.416, datë 8.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KARBUNARË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Karbunarë të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Karbunarë, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.769 datë, 19.11.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Karbunarë të qarkut të Fierit ".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Karbunarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
11-14	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
15-33	Shërbimet funerale	Në pronësi
34	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
69-89	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
90, 92, 98, 100, 102	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
91, 93, 94, 95, 96, 97, 99, 101, 103, 104, 105, 114, 115, 120	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

VENDIM
Nr.417, datë 8.6.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ÇËRRAVË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Çërravë të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 35 (tridhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 180 (njëqind e tetëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Çërravë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-6	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
7-14, 65-81	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
15-23	Varreza publike	Në pronësi
24-36	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
39-42, 175-180	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
43-50	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve social-kulturore e sportive	Në pronësi
82-90	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
102-104	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
105-107, 119, 131, 137, 141, 144, 160	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe vetëm kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM
Nr.418, datë 8.6.2011

PËR PROCEDURËN E HEQJES SË LICENCËS SË NDËRMJETËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" dhe të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve i heq licencën çdo subjekti, që ushtron veprimtarinë si ndërmjetës, në rastet e mëposhtme:

a) Me kërkesën e tij;

b) Në rast se humbet apo i kufizohet zotësia për të vepruar;

c) Kur dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale, të kryer me dashje;

ç) Kur vërtetohet shkelja e dispozitave urdhëruese dhe ndaluese të ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve";

d) Për shkelje të rënda të normave të Kodit të Etikës;

dh) Në çdo rast tjetër, kur parashikohet shprehimisht në ligj.

2. Procedura e heqjes së licencës fillon brenda 6 (gjashtë) muajve, por jo më vonë se 3 (tre) vjet nga kryerja e shkeljes. Kjo procedurë fillon me kërkesë të subjekteve të interesuara ose kryesisht nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve. Kur procedimi fillon me kërkesë të subjekteve të interesuara, kërkesa paraqitet pranë sekretarit të Komisionit dhe duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të hartohet me shkrim;

b) Të identifikojë ndërmjetësin, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen;

c) Të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje, dhe rrethanat e kryerjes së tij;

d) Të shoqërohet me akte të tjera të nevojshme që provojnë kryerjen e shkeljes.

3. Ndërmjetësi, ndaj të cilit ka filluar procedimi, ka të drejtë:

a) të informohet në mënyrë të qartë dhe të hollësishme për shkeljet që pretendohen dhe faktet rreth tyre;

b) të formulojë pretendime dhe kërkesa;

c) të njihet me dokumentet e procedimit dhe të depozitojë prova të mjaftueshme;

ç) të ketë asistencën e një avokati ose të një kolegu gjatë procedimit dhe të dëgjohet në prani të tij;

d) të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve, si dhe të paraqesë dokumente të tjera në mbrojtje të tij, jo më vonë se 2 (dy) javë nga fillimi i procedimit.

4. Komisioni, pas shqyrtimit të fakteve, rrethanave, si dhe pretendimeve të paraqitura nga palët gjatë procedimit, në rast se çmon se vërtetohet një prej rasteve të heqjes së licencës, vendos heqjen e saj. Për zhvillimin e mbledhjes zbatohen rregullat e parashikuara në vendimin nr.414, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe mënyrën e organizmit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve".

5. Vendimi i Komisionit për heqjen e licencës përmban të dhëna për:

a) organin që ka marrë vendimin;

b) identifikimin e ndërmjetësit, të cilit i hiqet licenca, dhe të dhënat e licencës;

c) shkeljen faktike;

ç) bazën ligjore;

d) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë procedimit, dhe përfundimet e nxjerra nga Komisioni;

dh) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;

e) të drejtën për të bërë ankim, afatin për paraqitjen e tij dhe organin përgjegjës për zgjidhjen e tij.

6. Kundër vendimit të Komisionit, kërkuesit mund të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë mund të bëhet ankim në gjykatë. Paraqitja dhe shqyrtimi i ankimeve bëhen sipas rregullave dhe afateve të parashikuara në ligj për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

7. Pas heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit, Komisioni i paraqet strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për administrimin e Regjistrit të Ndërmjetësve, vendimin për heqjen e licencës me qëllim bërjen e shënimit përkatës në regjistër, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, i cili mbahet nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

8. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.419, datë 14.4.2011

PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DËMSHPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist sipas planifikimit vjetor buxhetor dhe parimit të proporcionalitetit për të gjithë ish-të dënuarit dhe viktimat e ekzekutuara.

2. Në çdo rast, vlera e këstit të dëmshpërblimit është jo më e vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe jo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Afatet dhe skema e shpërndarjes së dëmshpërblimit sipas kësteve të përcaktuara me këtë vendim janë për të dënuarit politikë, të cilët kanë vuajtur dënimin me burgim, izolim në hetuesi ose në spital psikiatrik, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991; për familjarët e viktimave, të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht, me gjyq ose pa gjyq, për motive politike, nga data 30.11.1944, deri më 1.10.1991; si dhe për të dënuarit politikë të cilët kanë vuajtur dënimin me internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954.

4. Dëmshpërblimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave shpërndahet në tetë këste të barabarta.

5. Me termin "subjekt përfitues" nënkuptohet ish-të dënuarit politikë ose përfituesit e tjerë ligjorë.

6. Skema e shpërndarjes së kësteve të dëmshpërblimit për subjektet përfituese është, si më poshtë vijon:

a) Afati i shpërndarjes së kështit të dytë fillon pas përfundimit të miratimit të plotë të dëmshpërblimit për të gjithë ish-të dënuarit politikë;

b) Afati i shpërndarjes së kështit të tretë fillon një muaj pas përfundimit të pagesës së kështit të dytë për të gjitha subjektet përfituese;

c) Afati i shpërndarjes së kështit të katërt fillon një muaj pas përfundimit të pagesës së kështit të tretë për të gjitha subjektet përfituese;

ç) Afati i shpërndarjes së kështit të pestë fillon një muaj pas përfundimit të pagesës së kështit të katërt për të gjitha subjektet përfituese;

d) Afati i shpërndarjes së kështit të gjashtë fillon një muaj pas përfundimit të pagesës së kështit të pestë për të gjitha subjektet përfituese;

dh) Afati i shpërndarjes së kështit të shtatë fillon një muaj pas përfundimit të pagesës së kështit të gjashtë për të gjitha subjektet përfituese;

e) Afati i shpërndarjes së kështit të tetë fillon një muaj pas përfundimit të pagesës së kështit të shtatë për të gjitha subjektet përfituese.

7. Ministria e Financave, sipas buxhetit të vënë në dispozicion, shpërndan kështin e dytë të dëmshpërblimit dhe kështet e tjera në vijim, për çdo subjekt përfitues, sipas ligjit, me radhë përparësie:

a) Të dënuarit politikë, të mbetur gjallë me moshë mbi 65 vjeç;

b) Të dënuarit politikë dhe familjarët e viktimave, të ekzekutuara apo të pushkatuara padrejtësisht me gjyq ose pa gjyq, për motive politike, të cilët vuajnë sëmundje të rënda.

Llojet e dokumentacionit, ku vërtetohet gjendja e rëndë e subjektit përfitues dhe procedurat e paraqitjes së tyre, përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

8. Pagesa e kësteve, duke filluar nga kësti i dytë, do të bëhet sipas radhës kronologjike të kryerjes së pagesës së kështit të parë, me përjashtim të ish-të dënuarve politikë, të përmendur në pikën 7 të këtij vendimi. Ministri i Financave nxjerr rregulla për mënyrën dhe procedurën e kryerjes së pagesës.

9. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.420, datë 8.6.2011

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË ARBITRAZHIT NR.14869/AVHJEM, PËR ÇËSHTJEN "ROHDE NIELSEN VS MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit nr. 14869/AVHJEM, për çështjen "Rohde Nielsen vs Ministria e Punëve Publike dhe Transportit", në shumën prej 2 374 880,59 (dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë pikë pesëdhjetë e nëntë) eurosh.

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga Autoriteti Portual, Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoriteti Portual, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË
PËR SHPRONËSIM PUBLIK
Nr.454/3, datë 8.6.2011

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Librazhd-Qafë Studë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit: tokë arë, truall dhe objekte.

Për të gjitha pasuritë për të cilat është bërë shënimi "Rikonfirmim", do të kërkohet rikonfirmim pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd.

Për objektet është bërë shënimi "I pakonfirmuar", pasi nuk disponojmë të dhëna nga ALUIZNI dhe as nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Librazhd. Personat të cilët pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e këtyre objekteve pranë ZVRPP-së Librazhd, ose nëse kanë aplikuar pranë ALUIZNI-t, të paraqesin një kopje të formularit të vetëdeklarimit. Nga ana e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit do të mbahet korrespondencë me të dy këto institucione për të marrë informacionin përkatës ligjor.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 8 920 718.7 (tetë milionë e nëntëqind e njëzet mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONAREVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR "LIBRAZHD-Q.STUDË", LOTI 2
(Segmenti Gjorg-Golemi-Çermenika)

Nr.	PRONARI		Z.K.	NR.	ARË			TRUALL			OBJEKTE	VLERA	SHËNIME
	EMRI	MBIEMRI		PAS.	SIP.	ÇMIMI LEKË/M²	VLERA LEKË	SIP.	ÇMIMI LEKË/M²	VLERA LEKË	VLERA LEKË	TOTALE LEKË	
1	Refat	Kurti	2446	1/467				100	10500	1050000		1050000	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
2	Shefki	Dosku	1517	678	390	246	95940					95940	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
3	Xhemal	Dosku	1517	675	145	246	35670					35670	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
4	Shaban	Dosku	1517	666/12	93	246	22878					22878	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
5	Sami	Dosku	1517	666/11	68	246	16728					16728	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
6	Abaz	Dosku	1517	666/10	47	246	11562					11562	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
7	Gafur	Dosku	1517	666/9	92	246	22632					22632	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
8	Gafur	Dosku	1517	664/1	77	246	18942					18942	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
9	Riza	Dosku	1517	663/9	53	246	13038					13038	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
10	Riza	Dosku	1517	663/11	41	246	10086					10086	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
11	Abaz	Dosku	1517	665/1	30	246	7380					7380	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
12	Sami	Dosku	1517	665/2	20	246	4920					4920	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
13	Idajet	Biçaku	1517	663/8	31	246	7626					7626	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
14	Bujar	Muça	1517	650/4	338	246	83148					83148	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
15	Naze	Muça	1517	650/3	211	246	51906					51906	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
16	Hamide	Alla	1517	110	139	246	34194					34194	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
17	Gafur	Dosku	1517	1//23	650	246	159900					159900	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
18	Petrit	Allushi	1517	1//2	526	246	129396					129396	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
19	Petrit	Allushi	1517	1//3	76	246	18696					18696	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
20	Shyqyri	Allushi	1517	1//13	46	246	11316					11316	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
21	Selim	Biçaku	1517	20/2	61	246	15006					15006	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
22	Hamdi	Shkurti	1517	26/6	18	246	4428					4428	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
23	Muhamet	Shkurti	1517	26/3	583	246	143418					143418	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
24	Faik	Shkurti	1517	26/2	570	246	140220					140220	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
25	Shefqet	Shkurti	1517	566/1				136	1073	145928		145928	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së

26	Muhamet	Shkurti	1517	566/2				97	1073	104081		104081	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
	Faik	Shkurti											Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
27	Sefedin	Shkurti	1517	563/7	26	246	6396					6396	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
28	Shefqet	Shkurti	1517	563/8	25	246	6150					6150	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
29	Faik	Shkurti	1517	563/9	59	246	14514					14514	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
30	Shpetim	Rreshka	1517	563/10	97	246	23862					23862	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
31	Seit	Alla	3913	1002/1	203	269	54607					54607	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
32	Beshir	Boci	3913	710	11	269	2959					2959	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
33	Agim	Boci	3913	715	20	269	5380					5380	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
34	Beshir	Boci	3913	716	543	269	146067					146067	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
35	Izet	Boci	3913	543	181	269	48689					48689	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
36	Ismail	Qoshi	3913	540	218	269	58642					58642	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
37	Nazmi	Qoshi	3913	538	230	269	61870					61870	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
38	Bashkim	Qoshi	3913	536	184	269	49496					49496	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
39	Nazmi	Qoshi	3913	535	593	269	159517					159517	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
40	Fadil	Qoshi	3913	532	159	269	42771					42771	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
41	Hamit	Shuli	3913	520	342	269	91998					91998	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
42	Xhezar	Alla	3913	56	454	269	122126					122126	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
43	Uran	Alla	3913	57	448	269	120512					120512	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
44	Hamide	Alla	3913	1233				156	953	148668		148668	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
45	Arben	Alla	3913	71	520	269	139880					139880	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
46	Hamide	Alla	3913	72	132	269	35508					35508	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
47	Haki	Alla	3913	81	327	269	87963					87963	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
48	Hysni	Alla	3913	85	78	269	20982					20982	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
49	Arben	Alla	3913	89	363	269	97647					97647	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
50	Xhemal	Kaca	3913	93	496	269	133424					133424	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
51	Daut	Kaca	3913	95	197	269	52993					52993	Rikonfirmim pranë ZVRPP-së
52	Kadri	Qoshi	3913								2308290.3	2308290.3	I pakonfirmuar
53	Shahin	Meta	3913								2520768.4	2520768.4	I pakonfirmuar
					10211		**2642983**	**489**		**1448677**	**4829058.7**	**8920718.7**	

KËRKESË

Kërkuesja Burbuqe Mene, e bija e Idrizit dhe Azifes, e datëlindjes 1936, lindur në Fier dhe banuese në Michigan USA, me adresë: 35249 Grand Prix, me dokument identifikimi AZ 484105, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetases Vitore Ruka, e bija e Idrizit dhe Azifes, e datëlindjes 3.2.1926, lindur në Shkodër dhe me banim të fundit në Fier, lagjja "Kastriot", dhe caktimin e kujdestarit për administrimin e pasurisë së saj.

KËRKUESJA
Burbuqe Mene

KËRKESË

Kërkuesi Ilirjan Starova, i biri i Rafit dhe Lirisë, i datëlindjes 7.7.1982, lindur dhe banues në Elbasan, lagjja "5 maj", kërkon shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Aurel Starova.

KËRKUESI
Ilirjan Starova

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 23.6.2011
Doli nga shtypi më 25.6.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë